



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr. 419/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesuese, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit Partija Kosovski Serba (PKS), parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë :

#### **VE N D I M**

**HEDHEN TË PASAFATSHME** ankesat Anr.419/2025, Anr.420/2025, Anr.421/2025, Anr.422/2025, Anr.423/2025, Anr.424/2025, Anr.426/2025, Anr.427/2025 të datës 07.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS), kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datën 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.419/2025, Anr.420/2025, Anr.421/2025, Anr.422/2025, Anr.423/2025, Anr.424/2025, Anr.426/2025, Anr.427/2025 të datës 07.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS), kundër kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

-Ne ankesën Anr.419/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe vendosën posterë ( plakata) në Lesak në lokacionin e rrugës Braçe Matiq, (afër qendrës shëndetësore) mbi pemët e qytetit, gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 2.11. Në mbështetje të këtij pretendimi, po i bashkëngjisim një foto nga vendi i ngjarjes të realizuar nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës, më 02.02.2025, ku shihen postera të PKS-së, të cilat më pas janë shkatërruar në kundërshtim me rregulloren zgjedhore.

-Në ankese Anr.420/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe shkatërruan dhe ngjitën mbi postera të Partisë së Serbëve të Kosovës në vendin Leshak në lagjen Gragjevac, gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 4. Në mbështetje të këtij pretendimi, po bashkangjisim një fotografi nga vendi i ngjarjes, të realizuar nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës, më datë 01.02.2025, ku shihen posterët të PKS, të cilët më pas janë asgjësuar në kundërshtim me Rregulloren e Zgjedhjeve.

-Në ankese Anr.421/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe vendosën postera në Leshak, në vendbanimin Gragjevac (oborr i ndërtese banimi), gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 2.11. Në mbështetje të këtij pretendimi, po bashkangjisim një fotografi nga vendi i ngjarjes të marrë nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës, më 02.02.2025, ku shihen postera të PKS, të cilët më pas janë asgjësuar në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore.

-Në ankese Anr.422/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe vendosën postera në Leshak, në rrugën Brace Matic, (park i qytetit) përballë qendrës së votimit Leshak I në një distancë prej më pak se 100 m nga shkolla "Stana Baçanin", gjë që dënohet me nenin 7, paragrafin 2.11 dhe paragrafin 2.9. Në mbështetje të këtij pretendimi, po bashkangjisim një fotografi nga vendi i ngjarjes, të realizuar nga aktivistët e Partisë Serbe të Kosovës më 02.02.2025, ku shihen postera të PKS-së, të cilët më pas janë shkatërruar në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore.

-Në ankese Anr.423/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Srpska vendosën postera në Leshak, (park i qytetit) në lokacionin rruga Brace Matic, gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 2.11. Në mbështetje të këtij pretendimi, po bashkangjisim një foto nga vendi i ngjarjes, të marrë nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës më 02.02.2025, ku shihen posterat e shkatërruara në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore.

-Në ankese Anr.424/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Srpska hapën ilegalisht zyrën e partisë dhe vendosën pllakate të plastifikuar ( postera), si dhe video-përgjime të paligjshme në Laposaviq, rruga 24 Nentori, në lokalet nr. 15 dhe nr 26 " UNIVERZAL" të cilat janë në pronësi të Agjencisë së Kosovës për Privatizim dhe si të tilla nuk mund të merren me qira për punën e partive politike, qiramarrësi i të cilave në Agjencinë e Privatizimit nuk është i Listës Serbe, gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 2.4. Objektet e lartpërmendura i kanë emërtuar jo një, por dy parti politike, njëra prej të cilave SNS (Partia Progresive Serbe), e cila nuk është e regjistruar as në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës. Në mbështetje të këtij pretendimi, ju paraqesim një fotografi nga vendi i ngjarjes të realizuar nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës më 02.02.2025. Kjo parregullsi është raportuar nga ne në Agjencinë e Kosovës për Privatizim.

-Në ankese Anr.426/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe shkatërruan dhe ngjitën mbi posterët e Partisë së Serbëve të Kosovës në Laposaviq në lokacionin e Rrugës Rudarska, gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 4. Në mbështetje të këtij pretendimi, po ju bashkangjitim një fotografi nga vendi i ngjarjes, të realizuar nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës më 01.02.2025, ku shihen posterët e PKS-së, të cilët më pas janë shkatërruar në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore.

-Në ankese Anr.427/2025 pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe shkatërruan dhe ngjitën mbi posterët e Partisë së Serbëve të Kosovës në Laposaviq në lokacionin e rrugës 24 Nentori ( trafo stacion) , gjë që dënohet me nenin 7, paragrafi 4. Në mbështetje të këtij pretendimi, po ju bashkangjitim një fotografi nga vendi i ngjarjes, të realizuar nga aktivistët e Partisë së Serbëve të Kosovës më 01.02.2025, ku shihen posterët e PKS-së, të cilët më pas janë shkatërruar në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë subjektit politik Lista Serbe të Lidhur me ankesën e subjektit politik Partia e Serbëve të Kosovës ku thuhet se kemi shkelur nenin 7 të Rregullores së Zgjedhjeve Nr. 7/2024, për shkak se gjoja ua kemi shkatërruar posterat zgjedhore, dëshirojmë t'ju paraqesim këtë përgjigje: Në ankesë pretendohet se ne ua kemi shkatërruar posterat politikë, mirëpo fotografitë e bashkangjitura si provë nuk tregojnë asnjë gjurmë se ne kemi shkatërruar apo mbuluar posterat e tyre. Në të gjitha fotografitë e dorëzuara, duket qartë vetëm materiali ynë politik – posterat e subjektit tonë politik. Fotot tregojnë lokacione të shumta dhe disa postera, por të gjithë posterat në ato fotografi i përkasin ekskluzivisht subjektit tonë politik. Nuk ka asnjë gjurmë apo dëshmi më të vogël të shkatërrimit, mbi ngjitjes apo ndonjë lloj tjetër dëmtimi të posterave të subjekteve të tjera politike. Nga kjo mund të konstatohet qartë se imazhet e bashkangjitura nuk mund të jenë bazë për pretendimet që i kemi shkatërruar apo mbingjitur mbi postera të subjekteve të tjera politike. Nëse do të kishte shkelje të tilla, do të duhej të tregoheshin qartë dhe të dokumentoheshin në foto, gjë që nuk ndodh në këtë rast. Posterat e subjekteve të tjera politike as që duken, dhe më e rëndësishmja, nuk ka asnjë gjurmë dëmtimi apo zhvendosjeje të posterave të tjerëve, që do të ishte e nevojshme për të pretenduar se ne i kemi shkatërruar apo mbuluar. Prandaj, konsiderojmë se ankesa nuk e pasqyron saktë gjendjen faktike dhe ju ftojme që të rishqyrtoni provat e bashkangjitura duke marrë parasysh gjendjen e saktë faktike dhe ta refuzoni ankesën si të pabazuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.419/2025, Anr.420/2025, Anr.421/2025, Anr.422/2025, Anr.423/2025, Anr.424/2025, Anr.426/2025, Anr.427/2025 të datës 07.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.419/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesave, gjeti se:

**-Ankesat janë të e pasaftshme.**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS), parashtruar kundër Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesave ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 07.02.2025, ku ka pretenduar se subjekti politik Lista Serbe është përgjegjës për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesat janë dorëzuar më 07.02.2025, ndërkohë pretendimet lidhur me shkeljet parashtruesi i ankesave thekson se kane ndodhur me datën 01 dhe 02.02.2025 që do të thotë se ankesat janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.419/2025 më datën 09.02.2025

Kryesues i Panelit  
Ramush Bardhi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.